



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANE**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE E GJELBËRIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT**

Data: **19.06.2026**

**Drejtuar: “A.M.E 2020” shpk, NIPT K83725201G**

**Operatorit Ekonomik (OE)** ☐ ose

**Operatori ekonomik “A.M.E 2020” shpk, NIPT K83725201G dhe adresë: “Durrës Krujë BUDULL Mazhë e Madhe, Nr pasurie 57/3, zk 2621, Vol.5 Fq 216, Krujë.**

**Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)** ☐

*[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]*

**- OE/BOE me nënkontraktor**

**PO** ☐ **JO** ☐

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

**-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:**

**PO** ☐ **JO** ☐

Nëse po, të jepen dhënat: \_\_\_\_\_

*[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]*

Tipi i Kontratës: **Mall**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **E Hapur**

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: **REF-85330-05-12-2026**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Blerje Produktesh Agrokulturore (farëra, fidanë, lule sezonale dhe pleh”.**

Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: **11.06.2026**

<sup>1</sup>Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: **Buletini Nr.39, datë 15.06.2026**

### **KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:**

-oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐

-oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim **X**

**Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:**

#### **1. Operatori ekonomik “A.M.E 2020” shpk, NIPT K83725201G**

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave, **15.426.000** (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e njëzet e gjashtë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

#### **2. Operatori ekonomik “A l b g a r d e n” shpk, NIPT K37513520N**

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave, **11.874.000** (njëmbëdhjetë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

#### **3. Operatori ekonomik “Gjelbëmi 2000” shpk, NIPT L21513012D**

---

<sup>1</sup> Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave, **11.113.900 (njëmbëdhjetë milionë e njëqind e trembëdhjetë mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

**Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

**1. Operatori ekonomik “A l b g a r d e n” shpk, NIPT K37513520N**

*arsyet e mëposhtme:*

Në zbatim të **ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”**, i ndryshuar me **ligjin nr. 16/2024**, neni 93 **“Oferta anomalisht e ulët”**, pika 5, përcakton se në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.

Gjithashtu, në zbatim të **VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”**, e ndryshuar me **VKM nr. 710, datë 24.11.2021, VKM nr. 498, datë 01.08.2024 dhe VKM nr. 545, datë 04.09.2024**, neni 82, pika 4, përcakton se pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët.

Sipas kësaj dispozite, **në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta**, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se **25% e fondit limit të përlllogaritur**. Po kështu, në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një ofertë vlerësohet anomalisht e ulët, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave e refuzon atë, duke e skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit.

Në rastin konkret, pas përfundimit të shqyrtimit të dokumentacionit dhe verifikimit të ofertave të vlefshme, rezulton se në procedurë janë **dy ose më pak oferta të vlefshme**. Për rrjedhojë, për vlerësimin e ofertës anomalisht të ulët zbatohet kufiri prej **25% i fondit limit**.

**Fondi limit** i procedurës është **15,833,000 lekë pa TVSH**.

**25% e fondit limit** është:

**15,833,000 lekë × 25% = 3,958,250 lekë**

**Kufiri minimal i pranueshëm** është:

**15,833,000 lekë – 3,958,250 lekë = 11,874,750 lekë pa TVSH**

Oferta e OE “Albgarden” sh.p.k. është:

**11,874,000 lekë pa TVSH**

Kjo ofertë është më e ulët se kufiri minimal i pranueshëm:

**11,874,750 lekë – 11,874,000 lekë = 750 lekë**

Pra, oferta e OE “Albgarden” sh.p.k. është **750 lekë më e ulët** se kufiri minimal i pranueshëm dhe, për rrjedhojë, rezulton e ulur më shumë se **25%** nga fondi limit. Në këto kushte, oferta vlerësohet **anomalisht e ulët**.

Duke qenë se procedura është me vlerë **nën kufijtë e lartë monetarë**, në zbatim të **nenit 93, pika 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin nr. 16/2024**, si dhe **nenit 82, pika 4, të VKM nr. 285, i ndryshuar**, oferta e OE “Albgarden” sh.p.k. refuzohet pa kërkuar shpjegime nga ofertuesi dhe operatori ekonomik skualifikohet.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

## **2. Operatori ekonomik “Gjelbëmi 2000” shpk, NIPT L21513012D**

*arsyet e mëposhtme:*

Në zbatim të **nenit 92, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”,** autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë si të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE “**Gjelbërimi 2000” sh.p.k.**, rezulton se oferta nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.3**, ku përcaktohet se operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë/broshurë/skedë teknike për artikujt objekt prokurimi, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Gjithashtu, operatori duhet të markojë në katalog/broshurë/skedë teknike artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në **Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”,** me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, OE “**Gjelbërimi 2000” sh.p.k.** nuk ka paraqitur për produktet e ofertuar përshkrime të detajuara teknike, katalogë, broshura apo skeda teknike që të provojnë përmbushjen e specifikimeve të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Dokumentacioni i paraqitur është i përgjithshëm dhe operatori është mjaftuar me deklarin se **“Bimësia do të paraqitet në përputhje me specifikimet teknike dhe kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor”,** pa identifikuar konkretisht karakteristikat teknike të mallrave që

oferton. Ky deklaram i përgjithshëm nuk mund të zëvendësojë katalogun, broshurën apo skedën teknike të kërkuar shprehimisht nga kriteri 2.3.3, pasi nuk mundëson verifikimin objektiv të përputhshmërisë teknike të ofertës. Në mënyrë të veçantë, për zërat **Farë bari – Përzierje bari – 500 kg, Pleh organik i thatë – Pleh organik – 20,000 kg dhe Torfë organike për lule – Torfë me përbërje ushqyese – 2,000 litra**, nuk rezulton të jetë paraqitur asnjë katalog, broshurë, skedë teknike apo dokument tjetër teknik që të tregojë përbërjen, karakteristikat, parametrat cilësorë, përdorimin, origjinën apo përputhjen e këtyre produkteve me specifikimet teknike të kërkuara. Për rrjedhojë, operatori nuk ka provuar përmbushjen e kriterit 2.3.3.

**Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.2**, ku përcaktohet se, në rast se operatori ekonomik nuk është prodhues i mallrave objekt prokurimi, ai duhet të paraqesë **autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për mallrat e ofertuara**, ku të provohet lidhja me prodhuesin dhe të vërtetohet se operatori ekonomik është i autorizuar për tregtimin e mallrave objekt prokurimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se për zërat **“Pleh organik i thatë” dhe “Torfë organike për lule”**, të parashikuar në Formularin e Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit, operatori ekonomik nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi/distributori për këta artikuj, për të cilët nuk rezulton të jetë prodhues vetë. Për rrjedhojë, nuk provohet lidhja me prodhuesin dhe as e drejta e operatorit për tregtimin/furnizimin e këtyre mallrave objekt prokurimi, ndaj kriteri 2.3.2 nuk përmbushet.

**Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.7**, ku përcaktohet se operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të testeve zyrtare të kryera për mallrat objekt prokurimi, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi. Në pikën **a)** të këtij kriteri kërkohet paraqitja e **Certifikatës Zyrtare model 3, autorizimit për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit**, sipas modelit përkatës, si dhe **certifikatës së origjinës**, të lëshuara nga Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve, sipas VKM nr. 523, datë 13.07.2016, ose dokumentacioni përkatës në rast furnizimi nga prodhues/distributor/importues jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Nga verifikimi rezulton se operatori ka paraqitur **Certifikatë Zyrtare nr. serie 006, Certifikatë Origjine nr. serie 006 dhe Autorizim për nxjerrjen e etiketave të furnizuesit nr. serie 006**, të lëshuara më **10.06.2025**, si dhe dokumente me **nr. serie 008**, të lëshuara më **15.07.2025**. Në këto dokumente përcaktohet se vlefshmëria është **“deri më 30 prill të një viti më pas”**, që do të thotë se vlefshmëria e tyre ka përfunduar më **30.04.2026**. Për rrjedhojë, në momentin e zhvillimit të procedurës dhe të vlerësimit të ofertës, këto dokumente nuk kanë qenë më të vlefshme dhe nuk mund të konsiderohen dokumente të rregullta për përmbushjen e kriterit 2.3.7, pika a).

Për më tepër, dokumentacioni i paraqitur nuk përputhet me artikujt objekt prokurimi. Certifikatat dhe autorizimet i referohen kryesisht bimëve/fidanëve dekorativë si **bliri, panja, selvi, fotinia, tuja, oleander, evonimus, Buxus microphylla** etj., ndërkohë që në këtë procedurë kërkohen artikuj të tjerë, si **tulipanë/bulba për mbjellje, ciklaminë, lavandë, viola, tagetes, agapanthus, trëndafil kacavjerrës, loropetalum, fara të ndryshme lulesh, farë bari, pleh organik i thatë dhe torfë organike për lule**. Pra, dokumentacioni i paraqitur nuk provon certifikimin, origjinën apo autorizimin për mallrat konkrete objekt prokurimi.

Gjithashtu, **operatori ekonomik nuk përmbush kriterin 2.3.7, pika b)**, ku për zërin **“Humus/Torfë”** kërkohet shprehimisht paraqitja e **Certifikatës së Regjistrimit të produktit plehërues**, sipas ligjit nr. 17/2020, datë 17.02.2020, **“Për produktet plehëruese”**, certifikatë e cila duhet të jetë brenda afatit të vlefshmërisë në momentin e paraqitjes së ofertës. Nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton të jetë paraqitur asnjë certifikatë e tillë për produktin **Humus/Torfë**, çka përbën mospërmbushje të drejtpërdrejtë të këtij nënkriteri.

Edhe deklarata e datës **15.07.2025**, sipas së cilës mallrat do të shoqërohen me certifikatë fitosanitare në momentin e furnizimit, nuk mund të zëvendësojë dokumentacionin e kërkuar nga kriteri. Kriteret e kualifikimit kërkojnë paraqitjen e dokumenteve konkrete, të vlefshme dhe të verifikueshme në momentin e ofertimit; një deklaram për një veprim të ardhshëm nuk mund të shërojë mungesën e dokumenteve të vlefshme dhe as mungesën e certifikatës së regjistrimit për produktin plehërues.

Në këto kushte, OE **“Gjelbërimi 2000” sh.p.k.** nuk ka provuar përmbushjen e kriterëve **2.3.3, 2.3.2** dhe **2.3.7**, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion teknik të mjaftueshëm për verifikimin e specifikimeve teknike, nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi/distributori për zërat për të cilët nuk rezulton prodhues, dokumentet certifikuese të paraqitura kanë qenë të skaduara në momentin e procedurës, nuk përputhen me artikujt objekt prokurimi dhe nuk është paraqitur Certifikata e Regjistrimit të produktit plehërues për zërin **Humus/Torfë**. Për rrjedhojë, oferta e OE **“Gjelbërimi 2000” sh.p.k.** nuk konsiderohet ofertë e vlefshme në kuptim të **nenit 92, pika 3, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”**, dhe operatori ekonomik skualifikohet.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☐

Nëse po, të jepen dhënat \_\_\_\_\_

*(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik “A.M.E 2020” shpk, NIPT K83725201G** dhe me adresë: Durrës Krujë BUDULL Mazhë e Madhe, Nr pasurie 57/3, zk 2621, Vol.5 Fq 216, Krujë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **15,426,000 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e njëzet e gjashtë mijë) lekë** pa TVSH, është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme të Pastrimit dhe Gjelbërimit**, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **10** ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nëse nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet siguri i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **316.660 (treqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë**, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO     ☐                      JO     **X**

Nëse Po ( *Nr. \_\_ Datë \_\_ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik*)

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**